




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 27/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Murseli” Sh.p.k. & NTSH “Krasniqi” - Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE NPN “Dardania”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje”, me numër të prokurimit: 616-18-146-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 06.02.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Murseli” Sh.p.k. & NTSH “Krasniqi - Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje”, me numër të prokurimit: 616-18-146-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë,

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës dhe anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje”, me numër të prokurimit: 616-18-146-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, të njëjtin aktivitet AK-ja mund ta Ritenderoi nëse edhe me tutje ka interes konform dispozitave të LPP-së .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Murseli” Sh.p.k. & NTSH. “Krasniqi” – Kaçanik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 23.11.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 12.12.2018

Njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm 31.12.2018

Kërkesa për rishqyrtim me dt: 06.01.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 08.01.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Murseli” Sh.p.k. & NTSH. “Krasniqi” – Kaçanik, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.01.2019 me nr. 27/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje”, me numër të prokurimit: 616-18-146-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28, 59.4, 61, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2019 ka autorizuar

ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 01.02.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Autoriteti Kontraktues - "Komuna Prishtinë", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, lloji i kontratës është punë me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës se operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës më datën 06.01.2019, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore të paraqitura si në ankesën e deponuar në OSHP.

AK – Komuna Prishtinë më datën 08.01.2019, nxjerr vendim dhe refuzon të njëjtën kërkesë si të pa bazuar.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës se operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës OE NPN "Dardania"-Prishtinë, përkatësisht pala përmes ankesës pretendon se operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës ka ofertuar me çmime abnormale dhe atë në pozicionet: 1, 2, 5 dhe 10.

OE i propozuar për dhënie të kontratës për pozicionin 1, "Shërbimi, ore pune (çmimi) për (skip të jetë i kompletuar dhe i pajisur me çekan –hilt, sipas nevojës", ka ofruar çmimin 8 €, për njësinë "orë pune",

Për pozicionin nr. 2 "Shërbimi, orë pune (çmimi) për eskavator të madh mbi 20 ton (të jetë i kompletuar goma dhe zinxhir sipas nevojës)" ka ofruar çmimin 10 € për njësinë "orë pune",

Për pozicionin nr. 5, "Angazhimi i punëtorëve fizik për një punëtor. Punëtoret duhet të kenë në dispozicion: hilt me kompresorë, hilt me rrymë, fleks, aparat saldimi, dana të armaturës, çekana, pajsera, shkallë, gjenerator dhe pajisje tjera të nevojshme", ka ofruar çmimin 13 €, për njësinë "orë punë",

Për pozicionin 10, "Cisterna e ujit", ka ofruar çmimin 1 €, për njësinë "m³ orë punë".

Lidhur me atë që u përshkrua më lartë, përkatësisht sipas nenit 61, par 1, të LPP-së, potencohet se, "Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit,...". Sipas shkresave të lëndës nuk kemi hasur diku që AK, ka kërkuar sqarim lidhur me ofertën financiare apo ndonjë pozicion të caktuar. Për më tepër AK, tek oferta financiare, në pozicionin 4, 9 dhe 10, si njësi matëse ka aplikuar dy variante (m 3 dhe orë pune). Vlerësimi ynë është se aplikimi i

dy varianteve në njësisë matëse në ofertën financiare, kontrata eventuale nuk gjen zbatim në implementim.

Pretendimi tjerët ankimorë ka të bëjë kundër kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuara në aneksin 7, të dosjes së tenderit, përkatësisht me pajisjet teknike. Sipas shkresave të ofertës së operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës, rezulton që i njëjti e ka plotësuar të njëjtin aneks për të njëjtat pajisje, rrjedhimisht ka prezantuar dëshmitë dokumentare sipas kërkesës së AK-s, dëshmitë, librezat e qarkullimit, marrëveshjet për shfrytëzim dhe dokumentet unike doganore, sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Pretendimi tjetër dhe i fundit ankimor poashtu ka të bëjë kundër kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht projekteve të realizuara. Operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës në shkresa të lëndës posedon dëshmitë dokumentare listën e projekteve të realizuara, me gjithsej pese (5) projekte të përshkruara, dhe si dëshmi dokumentare përveç tjerash ka prezantuar kopjet e kontratave dhe referencave të përshkruara si më poshtë:

Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje, kontratë e lidhur me Komunën e Prishtinës, më datën 22.09.2017, me vlerë të përgjithshme prej 75 450.00 €,

Trajtimi i mbetjeve ndërtimore pjesa I dhe II, të lidhur me Komunën e Prishtinës, me datën 25.07.2017, në vlerë të përgjithshme prej 66 600.00 €,

Pastrimi i mbetjeve ndërtimore, të lidhur me Komunën e Prishtinës, më datën 22.10.2015, në vlerë totale prej 104 000.00€. AK, përmes kërkesës ka kërkuar punë të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit dhe në vlerë prej jo me pakë se 200 000.00€, në tri vitet e fundit pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Përfundimisht në mbështetje të asaj që u përshkruam më lartë propozimi ynë për AK/ Komuna Prishtinë është që lëndën ta kthej në rivlerësim me qëllim që të vetë vlerësoj nëse me njësi matëse si të tillë kontrata mund të gjejë zbatim dhe implementim sipas rregullave dhe ligjit për prokurim publik në fuqi.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr. 1) dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.02.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.02.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 06.02.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Murseli deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit në një pike ndërsa në 2 pika të tjera nuk pajtohemi, bazuar në nenin 61, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta në disa pozicione: Pozicioni 1. Shërbimi ore pune për skip duhet të jetë i pajisur me çekan-hilt i njëjti ka ofruar çmim prej 8 € për orë ku çmimet e tregut minimumi janë 40 € për orë. 2 Shërbimi për orë pune për ekskavator të mesëm deri në 20 ton gjithashtu të jete i kompletuar ka ofruar prej 10 € për orë ku 20 €, ky ekskavator shpenzon naftë në orë minimumi çmimi i tregut është 70 € për orë. 3. Angazhimi i punëtorëve fizik për një punëtor ka ofruar 13 € ku është çmim i lire duke pasur parasysh që punëtorët duhet të kenë hilt me kompresor, fleks aparat të saldimit, çekanë, paisera, kablllo e të tjera që është çmim i ulet. Gjithashtu pozicioni i fundit sa i përket paramanës Cisterna e ujit, ka ofruar çmim prej 1 € i cili është çmim abnormalisht shumë i ulet i cili duhet të jete minimum 30 € për orë pune. Pika tjetër tek lista e punëve të realizuara në 3 vitet e fundit i njëjti ka ofruar vetëm një reference siç ka kërkuar AK, referenca të tjera nuk janë të ngjashme siç ka ofruar OE i rekomanduar. Pika e fundit sipas aneksit 7 që Autoriteti ka vepruar ka kërkuar kamion vetëshkarkues me peshe mbajtëse 12m³ apo me shume 3 copë, i njëjti ka ofruar vetëm 1 copë. Kemi dëshmi për të 2 tjerat që i kanë nga 11m³ gjithashtu tek aneksi 7 nr. 2 AK ka kërkuar kamion vetëshkarkues minimumi 20m³ apo me shume OE i rekomanduar ka ofruar 1 kamion me targa 01-777-SS i cili është 11 m³ ku AK e ka marr për baze pesha maksimale e lejuar e ngarkesës që është 20.000.20 që vije në kundërshtim me atë që ka kërkuar AK, këtë kamion i njëjti nuk e plotëson fare prandaj mbështetemi në mendimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mekolli deklaroj: Autoriteti Kontraktues KK-Prishtinë ka udhëhequr një procedurë për rrënimin e objekteve pa leje vlera e parashikuar për këtë projekt 150.000 € gjithsej kanë konkurruar 3 OE, 2 të tjerë AK i ka konsiderua si të përgjegjshëm OE “MURSELI” dhe “KRASNIQI” ndërsa OE “Bashkimi” nga Prishtina nuk i ka plotësuar kërkesat teknike,

nuk ka pasur dëshmi të pajisjeve si dhe nuk ka plotësuar referencat sipas kërkesave të AK-së që do të thotë kanë mbetur vetëm 2 OE të përgjegjshëm. Pretendimet e OE ankues janë krejtësisht të pa bazuara dhe qesharake: për arsye se OE ankues në rend të parë është vetë ai i cili ka tejkaluar vlerën e parashikuar për vlera është 150.000 € ndërsa vlera e ofertës që OE ankues 182.500 € që është më e lartë se e parashikuara. Pretendimi 2 i ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë që nuk i ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale është i paqëndrueshëm, këto në të kemi si dëshmi edhe listën e pajisjeve të plotësuar ashtu siç duhet edhe poashtu edhe librezat e qarkullimit dhe DUD-at doganor për të gjitha pajisjet (i kam të gjitha librezat i prezantoj për panelin) ndërsa OE ankues nuk ka dorëzuar fare liste të pajisjeve. Pretendimi tjetër i ankuesit se OE i propozuar nuk ka ofruar listën e projekteve siç ka kërkuar AK është poashtu i paqëndrueshëm përkundrazi ka ofruar listat e projekteve listën e kontratave referencave ashtu të siç ka kërkuar AK, ndërsa OE ankues nuk ka plotësuar listën e projekteve nuk e ka plotësuar kërkesën dhe nuk e kemi konsideruar të përgjegjshëm. Në bazë të këtyre që u than më lart që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim është propozim i papranueshëm për AK-në. AK kërkon nga Paneli që ta hedhë si të pabazuar ankesën e OE ankues dhe vendimi i AK-së të mbetet në fuqi. Në kohën e sqarimeve për informata asnjë nga OE nuk kanë kërkuar sqarime për pozicionin ku shënohet ora dhe për m³.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Bibaj deklaroi: Pretendimet ankimore të përfshira në ankesë janë trajtuar veç e veç, arsyeja kryesore se pse kam aprovuar ankesën si pjesërisht të bazuar ka të bëjë me pretendimin ankimore të pozicioni 10 të paramanës ku AK përveç këtij pozicioni edhe në pozicionin 4 dhe 9 tek rubrika si njësi matëse ka aplikuar 2 variante: m²/orë pune, m³/orë pune. Në raport kam vlerësuar se aplikimi i 2 varianteve me njësi matëse në rast të kontratës eventuale nuk mund të gjëjë zbatim të mirëfilltë prandaj propozimi im meqenëse në fazën e kriterëve nuk ka pasur ndonjë kërkesë për sqarim apo kërkesë për rishqyrtim kam propozuar që AK përmes rivlerësimit të ofertave të vlerësojë vet nëse me njësi matëse të tillë mund të këtë zbatim të kontratës së mirëfilltë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, sqarimeve analizës konkrete, rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe shoshitjes së provave në tërësi në shqyrtim kryesor, konstaton se Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë, përmes dosjes së tenderit përkatësisht përmes paramasës dhe parallogaritje, tek njësia matëse ka aplikuar dy variante siç janë “orë pune dhe metër katrorë” si dhe “orë pune dhe metër kub”. Veprimi si i tillë bie ndersht me rregullat dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik në fuqi dhe se kontrata eventuale me dy variante në njësine matëse nuk gjen zbatim të mirëfilltë, sepse nuk ka mundësi si të bëhet pagesa për

pozicionet e kryera sepse janë te vendosura nga dy njësi matëse, prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe në rast të ri tenderimit AK, duhet të përcaktohet për njërin variant dhe se dosja e tenderit te përgatitet në pajtim me nenin 27 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Prishtinë

1x1 OE- “Murseli”Sh.p.k. & NTSH “Krasniqi” – Kaçanik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.